

KOMUNIKIMI MUZEOR SI DËSHMI E LASHTËSISË DHE E IDENTITETIT KOMBËTAR

*Dil, ec e shko kudo – muzeun vizito!
Me trashëgiminë e të parëve, komuniko!*¹

Hyrje

Libri “Komunikimi Muzeor”² i autorit Shefki Stublla³, i përbërë prej dy vëllimesh, është një studim teorik e praktik, hulumtim i mirëfilltë tërësor. Autori, në cilësinë e profesorit, synon t’u përcjellë studentëve, muzeologëve të ardhshëm në Kosovë dhe në Shqipëri, njohuritë teorike e praktike dhe përvojën vetjake shumëvjeçare, por edhe atë botërore në komunikimin muzeor, por jo vetëm.

Tema kryesore e këtij libri është komunikimi i organizuar muzeor ndër ne, por edhe format e tjera të komunikimit në familje e me gjerë. Me të drejtë, autori përpiket të paraqesë sa më saktë historinë e komunikimit muzeor, kushtet ekonomike-historike të njerëzve të asaj treve, të cilët me shumë mund dhe në rrethana tepër të vështira nga pushtimet shumëshekullore, arritën të mbronin të kaluarën, duke ua lënë si dëshmi dhe pasuri pasardhësve të tyre.

Një vështrim panoramik

Vëllimi i parë përmban 36 kapituj. Secili prej tyre rrok e përfshin një temë, trajton një nga aspektet e muzeut si institucion i historisë, kulturës,

1 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor I*, Prishtinë, 2012, f. 17

2 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor I*, Prishtinë, 2012, botues Shoqata Kulturore e Kosovës “Anton Pashku”, f. 426.

3 Shefki Stublla është një magjistër i historisë së kulturës. Profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe, me një gamë të gjerë veprimtarish kulturore-shkencore. Ka udhëhequr Bashkësinë e Kulturës së Kosovës si dhe ka drejtuar Muzeun e Historisë. Botues i shumë eseve, artikujve nëpër gazeta e revista dhe i tre librave praktikë të cilët u vlerësuan lart nga kritika.

edukatës, të mendimit dhe të veprimit të shoqërisë në rrjedhën e kohërave. Çdo kapitull, nga mënyra si është perceptuar, shtjelluar e trajtuar, me një stil të shtruar diturak, gjuhë të qartë sipas parimit pedagogjik “*Nga e njohura tek e panjohura*” është në vetvete një leksion, një ligjëratë e veçantë.

Grupin e parë e përbëjnë kapitujt ku trajtohen çështjet që lidhen me komunikimin muzeor:

- Përcaktimi kuptimor i komunikimit muzeor;
- Përvojat e para të komunikimit muzeor në Kosovë;
- Muzeu, urë komunikimi me tri harqe;
- Miti i trilluar serb për Kosovën – komunikim i rrezikshëm ndëretnik;
- Lidhja Shqiptare e Prizrenit – komunikim mbarëshqiptar;
- Specifikat e komunikimit;
- Përmbytja bazike e komunikimit muzeor;
- Komunikimi muzeor nëpërmjet mjeteve elektronike dhe të shkruara;
- Misioni shoqëror i komunikimit muzeor;
- Parku etnik ose muzeu në natyrë – formë e përshtatshme e komunikimit;
- Koleksionet private – trajtë efektive e komunikimit me publikun;
- Tradita e trashëgimisë kulturore dhe komunikimi me të;
- Gjuha e komunikimit muzeor;
- Gjuha shqipe e komunikimit muzeor;
- Alfabeti i njësuar i gjuhës shqipe – funksioni i tij komunikues gjithëkombëtar;
- Etika e komunikimit muzeor;
- Koleksionet private – trajtë efektive e komunikimit me publikun.

Grupi i dytë ka natyrë historike, tipologjike, organizative dhe administrative për muzeologjinë:

- Kur u themeluan muzetë në Kosovë;
- Koha e re dhe muzeu;
- E kaluara në peshoren muzeore në Kosovë;
- Gjendja e muzeve sot në Kosovë, histori e shkurtër e zhvillimit të komunikimit muzeor në botë;
- Koleksionet e para të trashëgimisë kulturo-historike;
- Muzeu i familjes Gjinolli në Prishtinë;
- Tradita, identiteti kombëtar dhe globalizmi;
- Etika muzeore dhe identiteti;
- Kodi etik muzeor i “Ikom”-it;

- Funkzioni dhe roli i muzeut në kohën moderne;
- Llojet e muzeve – klasifikimi i tyre;
- Ekspoziti – objekti muzeor si dëshmi;
- Orientimi i muzeut nga tregu dhe nga shfrytëzuesit potencialë;
- Dokumentacioni në muze dhe klasifikimi i tij;
- Plani tematik – ekspozues – skenar i domosdoshëm.

Autori e sheh dhe e vlerëson muzeun si “një urë komunikimi me tri harqe”, që lidh të djeshmen (të kaluarën), të sotmen (të tashmen) dhe të nesërmen, duke hapur rrugët e së ardhmes.

Muzeu konsiderohet si një bankë e posaçme, ku ruhet e sigurohet pasuria jonë kombëtare, dokumente, të dhëna dhe dëshmi të historisë së lashtë e të re, zakonet e traditat shpirtërore e materiale të jetës, të kulturës dhe të qytetërimit tonë. Njëherësh, muzeu është një përçues e propagandues i historisë sonë mijërvjeçare. Ai pret e përcjell, një e nga një, brezat⁴, vizitorë shqiptarë e të huaj. Është ky një komunikim me objektet e sistemuara në stendat muzeore. Treguesit “flasin” me “gjuhën” e tyre, u drejtohen vizitorëve dhe u tregojnë, po aq sa ciceronët, ua nxisin intuitën e meditimin krijues. Profesor Shefkiu idetë e tij për “Komunikimin muzeor” i trajton gjerësisht në kapitujt e grupit të parë, si “Muzeu urë komunikimi me tri harqe”, specifika e komunikimit, gjuha e komunikimit muzeor etj. Ndaj shpreh mendimin se koncepti “Komunikim muzeor” mund të vlerësohet si një risi në sistemin e komunikimit publik.

Padyshim që mjetet e tjera komunikuese, sikurse janë televizioni, interneti, dokumentarët, filmat, janë dëshmi e lidhjeve me të shkuarën. Por asnjëri prej tyre nuk mund të krahasohet me muzeun, ku dëshmitë janë të prekshme, ku mund t’i shohësh nga afër dhe t’i përjetosh, sikur po jeton në kohën që i përkasin.

Komunikimi muzeor dhe trashëgimia kanë ligjet e veta. Vetëm duke punuar e duke hulumtuar pareshtur, mund të komunikohet me të.⁵ Komunikimi i mirëfilltë muzeor ka një kusht: njohuritë për të kaluarën duhen shpërndarë në mesin e njerëzve.⁶ Dituria duhet futur në përdorim, në edukim, në mbarë shoqërinë.⁷ Pra, e kemi për detyrë të njohim të kaluarën tonë. Të komunikojmë me të. Të njihemi me përmbajtjen e saj. Dhe, në asnjë mënyrë të mos largohemi nga ajo, sepse pa të jemi më të

4 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor 1*, Prishtinë, 2012, f. 55.

5 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor 1*, Prishtinë, 2012, f. 13.

6 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor 1*, Prishtinë, 2012, f. 14.

7 Po aty.

varfër, nuk ekzistojmë. Madje mbetemi pa identitet.⁸

Dëshmitë flasin dhe tregojnë përpjekjet e herëpashershme të pushtuesve dhe armiqve për t'i prerë rrënjët e veçorisë sonë të mirëfilltë kombëtare, me qëllim zhdukjen e vlerave shpirtërore dhe shenjave të patjetërsueshme të popullit tonë. Në muze gjejmë zanafillën e shkrimeve të gjuhës shqipe të “Meshari” i Gjon Buzukut, madje edhe më herët në shkrimet e Teodor Shkodranit. Atje gjejmë gjurmët e shkrimeve, por edhe atë çfarë është shkruar, mënyrën e të menduarit, aftësitë artistike, rrënjët e kulturës sonë perëndimore, duke përmendur këtu, “Kodikët e Beratit” e deri tek “Iliada” e Homerit. Në muzetë më në zë të botës gjejmë në piktura dhe skulptura shenja të patjetërsuara të veshjeve tona kombëtare mijërvjeçare. Plisi, fustanella dhe xhubleta janë më të spikaturat. Në muzetë e botës, përveç të tjerash, gjejmë shqiptarë që themeluan shtete të tilla si Turqia dhe Egjipti.

Pikërisht për këtë, muzeu ka për detyrë të ruajë ato që vërtetojnë prejardhjen e njerëzve të këtyre trojeve të lashta, që të mos shkelet e fshihet nga koha. Duke ruajtur dhe duke kujtuar me kujdes të kaluarën e lashtë amtare: doket, zakonet, folklorin, veshjen, arkitekturën popullore, gjuhën etj., do arrijmë të ruajmë fort edhe identitetin tonë kombëtar.

Në rastin e Kosovës, trashëgimia amtare kërkon qasje të menjëhershme muzeore-shkencore, kërkon etikë të lartë dhe komunikim shkencor, duke parë që shumë gjëra po zhduken pa mëshirë.⁹

Rasti i lahutës është dëshmia më e fundit e kësaj, ku UNESCO e përfshiu këtë instrument në listën përfaqësuese të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale të Njerëzimit për vitin 2018, si pasuri jomateriale e Serbisë.

Përhapja gjeografike e lahutës ndër shqiptarë është e gjerë dhe kjo përkon me përhapjen e këngëve të kreshnikëve. Por, fatkeqësisht, një vend tjetër do të krenohet me të, duke e quajtur si pasuri kombëtare.¹⁰

Historinë tonë e ngritëm ne vetë, për këtë kemi punuar fort në çdo drejtim, si në sajimin e mjeteve të punës me të cilat u arrit të ndërtoheshin vendbanime, zejтари, veshmbathje, punimet artizanale etj. Të gjitha këto u bënë faktorë vendimtarë për t'u identifikuar si komb i barabartë mes kombeve.

Shqiptarët e dikurshëm ndërtuan qytetërime. Muzetë në natyrë e vërtetojnë këtë më së miri, si Butrinti, Apollonia apo edhe më të hershme si Maliqi, një zonë e rëndësishme arkeologjike, ndër të vetmet në Shqipëri për periudhën e paleolitit të hershëm.

8 Po aty.

9 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor 1*, Prishtinë, 2012, f. 67.

10 <https://telegrafi.com/vendimi-skandaloz-unesco-s-lahuta-eshte-pasuri-kombetare-e-serbeve>

Nga gërmimet arkeologjike aty janë gjetur ndërtesat palafite (ndërtesa me drurë mbi ujë) si dhe shumë sende të rëndësishme me vlerë arkeologjike.¹¹ Gjithashtu, vlen të përmendim edhe zbulimin e vyer arkeologjik në Kosovë. Figura e një femre dardane në një statujë të mermertë është gjetur në lokalitetin arkeologjik të Ulpianës, e cila përfaqëson artin, kulturën materiale të periudhës dardane.

¹²Vëllimi i dytë përmban 29 kapituj të ndarë po ashtu në disa nënkapituj. Hapet me një hyrje tepër interesante, duke vazhduar më pas me: Komunikimi dhe Antroponimia; Eponimia e emrit; Komunikimi në familjen shqiptare; Komunikimi i nënës plakë me fëmijën; Mbiemri si tipar i emrit; Komunikimi me simbole – komunikim joverbal; Himni dhe flamuri kombëtar – formë e veçantë e komunikimit simbolik; Amuletet ilire; Rrobat dhe stolitë – simbole të komunikimit joverbal; Dhurata – simbol etnografik; Veçoritë individuale të komunikimit me ngjyra; Vallet popullore shqiptare – komunikim identifikues; Kënga dhe instrumentet muzikore shqiptare – dëshmi e komunikim identifikues kombëtar; Cikli vargor i jetës – komunikim i mirëfilltë dhe shenjat e horoskopit; Gjuha e trupit dhe shprehja e fytyrës; Komunikimi i njeriut me spektrin e ngjyrave; Komunikimi i njeriut me kafshët dhe shpendët; Komunikimi me kafshët dhe shpendët në traditën shqiptare; Tingullimitimet e disa kafshëve, shpendëve dhe sendeve; Komunikimi me nëntokën; Komunikimi me varrezat; Adetet e varrosjes të shqiptarët; Sharjet, ofendimet, mallkimet, përgojimet; Shpifjet, mbartja e fjalëve, nënçmimet, përdhunimet, përqeshjet – komunikim i papranueshëm verbal dhe joverbal; Komunikimi ndërjetar shqiptar; Komunikimi i njeriut me kohën; Ndarja ilire e motmotit; Komunikimi me dëshmi dhe me numra; Literatura.

Ku ruhet kujtesa e një populli?

Në botën e qytetëruar kujtesa e një populli ruhet në muze dhe në institucione të tjera përkatëse të kulturës së trashëgimisë.¹³ Dokumentimi,

11 <https://sq.wikipedia.org/wiki/Maliqi>

12 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor II*, (Aspekte Antroponimike dhe Antropologjike), Prishtinë, 2012, botues Shoqata Kulturore e Kosovës “Anton Pashku”, f. 368.

13 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor II*, Prishtinë, f. 2013.

interpretimi dhe prezantimi i realitetit të paraardhësve tanë është një nga sfidat e muzeut apo edhe institucioneve të tjera sot. Është koha për komunikim të mirëfilltë midis nesh.¹⁴

Në vëllimin e dytë “Komunikimi Muzeor” autori, me mjeshtëri, shpjegon rëndësinë e njohjes së komunikimeve të ndryshme në të shkuarën, duke i analizuar ato në detaje. Na tregon eponiminë e emërtimeve shqip të njerëzve, kafshëve, sendeve etj. Një rëndësi të veçantë ka edhe komunikimi në familjen shqiptare, si dëshmi e zakoneve tona. Nëpërmjet veshjeve e valleve shqiptare, është krijuar një shpalosje e mirëfilltë e veçorive kombëtare.

Kultura e veshjes tradicionale shqiptare karakterizohet me mbajtjen e plisit me maramë të bardhë, kurse te femrat mbajtja e shamisë. Një veshje të tillë, të gjerë dhe të gjatë, e gjen sot në muzetë e veshjes europiane.¹⁵ Kjo dëshmon edhe njëherë rëndësinë që ka etnografia shqiptare, e cila numëron 140 forma të ndryshme të veshjeve tona kombëtare.¹⁶ Ruajta e tyre me këmbëngulje ndihmon për të dëshmuar lashtësinë e vendit tonë. Pasuria e folklorit shqiptar, vallet tona popullore, këngët, instrumentet muzikore, shërbejnë po ashtu si mjet njohës i kombit shqiptar.

Muzeu, në të shumtën e rasteve, konsiderohet si një barnatore shpirtërore, ku çelen sytë, ku freskohet mendja, ku zgjerohet dija, ku gjenden këshillat mendore të përvojës për ecje përpara.¹⁷

Ndaj është e rëndësishme të njihemi me të, të japim ndihmesën tonë dhe t’i mësojmë brezat në vazhdim për rëndësinë e saj, si një nga shtyllat kryesore të ruajtjes së identitetit tonë kombëtar.

14 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor II*, Prishtinë, 2013, fq. 16

15 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor II*, Prishtinë, 2013, fq. 133

16 Po aty.

17 Shefki Stublla, *Komunikimi Muzeor II*, Prishtinë, 2013, fq. 12